



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:017493
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05849825

K.DH.SH.II.nr.763/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit avokat Labinot Vata, me adresë në rr. "Bardhyl Qaushi" Kompleksi KAWA, Hyrja D, nr.1, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga avokate Marigona Berisha me zyre në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.957/23 të datës 10.01.2024, me datë 24.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Labinot Vata, me adresë në rr. "Bardhyl Qaushi" Kompleksi KAWA, Hyrja D, nr.1, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.957/22 të datës 10.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.957/22 të datës 10.01.2024, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Fushë Kosovës, duke e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.298/23 datë 15.05.2023 të lejuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave materiale dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës përmbartimore, me propozimin që të aprovohet ankesa dhe aktvendimi i atakuar të ndryshohet, refuzohet prapësimi dhe të mbetet në fuqi Urdhri përmbartimor P.nr.298/23 datë 15.05.2023, detyrohet debitori të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 312€ në fat prej 7 ditësh.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit avokat Labinot Vata, ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. 298/23 i datës 15.05.2023 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Marrëveshje e Ndërmjetësimit nr. 038/2022 e datës 27.12.2022, duke detyruar debitorin Komuna e Fushë Kosovës që në emër të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e lartcekur, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 312.00 EUR (me shkronja: treqind e dymbëdhjetë euro) me kamatë vonesë 8% e nga dita e lejimit të këtij propozimi deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përmbartimore në vlerë prej 117.00 euro si dhe të gjitha shpenzimet tjera që do të krijohen në këtë procedurë.

Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.957/22 të datës 10.01.2024, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Fushë Kosovës, duke e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.298/23 datë 15.05.2023 të lejuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se Sipas nenit 21 të LPP-së, “Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa, me nenin 22, pika 1.4 të LPP-së, si një nga dokumentet përmbartuese përcaktohet “marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit ne pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin”. Gjykata në rastin konkret ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor Marrëveshje e ndërmjetësimit nr. 038/2022 e datës 27.12.2022 mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi, dhe gjeti se palë kontraktuese, përkatësisht kreditor në këtë marrëveshje paraqiten D.H., H.Q., V.D., Xh.K., DHE B.S., të përfaqësuar nga avokat Labinot Vata si dhe Komuna e Fushë Kosovës në anën tjetër në cilësi të debitorit. Në këtë drejtim, Gjykata gjen se kreditori i listuar në propozimin për përmbartim avokat Labinot Vata, nuk është palë në marrëveshjen e ndërmjetësimit por se i njëjti ka vepruar në cilësi të të autorizuarit të palëve, prandaj i njëjti nuk është i autorizuar që të kërkoj realizimin e detyrimit monetar prej 312.00 EUR, pasi që kjo kërkesë monetare i është njohur palëve pjesëmarrëse në procedurën e ndërmjetësimit si shpenzim për përpilimin e padisë nga ana e përfaqësuesit të autorizuar. Si rrjedhojë, avokat Labinot Vata ka mundur të kërkoj realizimin e kërkesave monetare që derivojnë nga kjo marrëveshje vetëm në emër dhe për llogari të palëve kreditore në marrëveshjen e ndërmjetësimit, por jo në cilësinë e tij personale.

Nisur nga një gjendje e tillë, gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, paragrafi 1, pika 1.6, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se “prapësimi mund të bazohen vetëm nëse”, ndër të tjera, “kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin kundër debitorit” andaj edhe urdhri përmbartimor të anulohet sepse përkundër faktit që kreditori Labinot

Vata figuron si kreditor në propozimin për përmbarim, i njëjti nuk e ka cilësinë e kreditorit në dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas nenit 21 të LPP-së, “Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa, me nenin 22, pika 1.4 të LPP-së, si një nga dokumentet përmbaruese përcaktohet “marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin”. Dokumentin përmbarimor përkatësisht Marrëveshja e ndërmjetësimit nr. 038/2022 e datës 27.12.2022 mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi, palë kontraktuese, përkatësisht kreditor në këtë marrëveshje paraqiten D.H., H.Q., V.D., Xh.K., DHE B.S., të përfaqësuar nga avokat Labinot Vata si dhe Komuna e Fushë Kosovës në cilësi të debitorit. Prandaj gjykata gjen se kreditori i listuar në propozimin për përmbarim avokat Labinot Vata, nuk është palë në marrëveshjen e ndërmjetësimit por se i njëjti ka vepruar në cilësi të autorizuarit të palëve, prandaj i njëjti nuk është i autorizuar që të kërkojë realizimin e detyrimit monetar prej 312.00 EUR, pasi që kjo kërkesë monetare i është njohur palëve pjesëmarrëse në procedurën e ndërmjetësimit si shpenzim për përpilimin e padisë nga ana e përfaqësuesit të autorizuar. Si rrjedhojë, avokat Labinot Vata ka mundur të kërkojë realizimin e kërkesave monetare që derivojnë nga kjo marrëveshje vetëm në emër dhe për llogari të palëve kreditore në marrëveshjen e ndërmjetësimit, por jo në cilësinë e tij personale.

Neni 71, paragrafi 1, pika 1.6, të LPP-së, përcaktohet se “prapësimi mund të bazohet vetëm nëse”, ndër të tjera, “kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin kundër debitorit” andaj gjykata e shkallës së parë mbi bazën e kësaj dispozite ligjore me të drejte e ka anuluar urdhrin përmbarimor, për arsye se, edhe pse kreditori Labinot Vata figuron si kreditor në propozimin për përmbarim, i njëjti nuk e ka cilësinë e kreditorit në dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi.

Ne baze të dispozitave ligjore të lartcekura, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se kreditori Labinot Vata figuron si kreditor në propozimin për përmbarim, por i njëjti nuk e ka cilësinë e kreditorit në dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, të njëjtat i vlerëson si të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se Labinot Vata nuk e ka cilësinë e kreditorit në dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SHK.II.nr.763/24 dt.24.06.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi